



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1107/2021

~~Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllgjani kryesuese, Milena Deric dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në rrugë publike, në Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.11.2021, mori këtë:~~

### VE N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.1107/2021 e datës 08.11.2021, Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në rrugë publike, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale, që do të mbahen më datë 14.11.2021.

### A r s y e t i m

PZAP, me datën 08.11.2021, ka pranuar ankesën Anr.1107/2021, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës në të cilat pretendon se me datë 08.11.2021 rreth orës 13:30 kanë vërejtur se aktivistët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje që kanë shpërndarë material zgjedhor në sheshin “4 Dëshmorët” në Podujevë. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur dy fotografi të printuara.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe janë sanksionuara me dispozitën ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së, dispozita të zbatueshme në kuptim të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

PZAP, me datë 09.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje duke i kërkuar që të përgjigjet deri me datë 10.11.2021, në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.11.2021 Subjekti Politik LVV e kundërshton pretendimin nga se subjekti politik LVV me datën dhe orën e cekur si në ankesë nuk ka vendosur dhe nuk ka shpërndarë material zgjedhor në sheshin “4 Dëshmorët”, e vërteta është se baneri “Bëhu Vullnetar – Lëvizja Vetëvendosje” përveç se nuk përmban elemente në lidhje me fushatën zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2021 është hequr me datë 05.11.2021 nga lokacioni i lartpërmendur.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë gjithashtu pretendon se subjekti politik LVV me datën dhe orën e lartcekur në ankesë ka bërë hapjen e fushatës elektorale dhe nga pamjet në foto dhe video të cilat i kemi bashkangjitur ankesës në sheshin “4 Dëshmorët” përkatësisht në vendin në të cilin pretendon ankuesi nuk shihet asnjë material zgjedhor i Subjektit Politik LVV i vendosur në shesh, përpos mbishkrimit i cili është i vendosur në objektin në të cilin LVV në Podujevë e ka selinë e saj.

Si provë ka bashkangjitur video-linkun nga faqja zyrtare e Facebook-ut e kandidatit për Kryetar të Podujevës Shpejtim Bulliqi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

**Ankesa është e palejuar.**

Sipas Nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periodha për Raundin e Dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunave, e përcaktuar sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) fillon me datë 8 Nëntor dhe zgjatë deri me datë 12 Nëntor, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli vlerëson se ankesa në fjalë është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka shpërndarë material zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që në fotografitë dhe linku i bashkangjitur në përgjigje në ankesë shihet vetëm një video incizim i publikuar në të cilin nuk vërehet se ka të shpërndarë material zgjedhor në sheshin “4 Dëshmorët”, dhe se baneri “Bëhu Vullnetar – Lëvizja Vetëvendosje” ishte larguar nga sheshi me datë 05.11.2021 nga lokacioni i lartpërmendur.

Veprimet e parashtruara në ankesë nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes sepse shkelja e pretenduar ka ndodhur para fushatës zgjedhore dhe baneri ishte eliminuar më datë 05.11.2021, dhe këto veprimet janë të sanksionuara ku sipas LZP-së, Kodit i Mirësjelljes neni 33 -Veprimet e ndaluara të subjekteve politike, pika b: “vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike...” në rastin konkret subjekti politik LVV e ka dëshmuar me linkun në të cilin e ka bashkangjitur si provë që shkelja e pretenduar- baneri ne ditën e hapjes se fushatës nuk gjendet në lokacionin e pretenduar.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.1107/2021 më datën 11.11.2021

Kryesuesja e Panelit  
Afijete Sada-Glogjani



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.